

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“BALSOMED” sh.p.k**

Tiranë, më datë 09/12/2021

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “BALSOMED” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “BALSOMED” sh.p.k

**NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Sherbime Keshillimi, Shitje ne Seli dhe Shitje Online produktesh fizioterapie, Organizim Kursesh ne fushën e Mjekesise dhe Fizioterapise, shërbime fizioterapie dhe rehabilitimi, cdo lloj veprimtrarie te ligjshme qe konsiderohet fitimprurese per shoqerine.

**NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kavajes, Godina Nr 50, Kati dyte, ish godina e Volksvagen, Njesia Administrative Nr.7, Tirane.

**NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 1,000 (Nje Mije) Euro. Kapitali ndahet në një (1) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Gregor Comploi, lindur në Bolzano, më 09.07.1985, shtetas Italian, me nr. ID CA61484GV, zotëron 100% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (1.000) Euro.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

**NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

1/3 Faqe



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ina Kulli, lindur në Krujë, më 20.02.1990, shtetas Shqiptar, me nr. personal J05220011C, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.


#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**



Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


### **NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Akt Themelimi u përkthye ne gjuhen Italiane nga znj. Ina Kulli

### **ORTAKËT**

Gregor Comploi

  
\_\_\_\_\_  
(emer, mbiemër, firmë)

3/3 Faqe

